



SHËRBIMI SOCIAL

BULETINI MUJOR

Shkurt
2026

Më datë 11 shkurt 2026 u zhvillua aktiviteti vjetor mbi shërbimet e financuara nga Fondi Social, një ngjarje që për të disatin vit radhazi konfirmon angazhimin institucional për forcimin dhe konsolidimin e sistemit të shërbimeve sociale në vend.

Drejtoresha e Përgjithshme e SHSSH-së, znj. Reme Xholi, nënshkroi marrëveshjet e bashkëpunimit me kryetarët e bashkive përfituese nga Fondi Social 2026. Nëpërmjet këtyre marrëveshjeve, harta kombëtare e shërbimeve sociale do të zgjerohet me 14 shërbime të reja, të projektuara për t'iu përgjigjur nevojave konkrete të kategorive më vulnerabël të shoqërisë, përfshirë fëmijët pa kujdes prindëror, gratë dhe vajzat e dhunuara, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, si edhe individët dhe familjet që përballen me vështirësi socio-ekonomike.



Në Korçë u zhvillua retreat-i tradicional i stafit të Shërbimit Social Shtetëror, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Drejtorisë së Përgjithshme dhe stafeve të 12 drejtorive rajonale nga e gjithë Shqipëria.

Ky retreat shërbeu si një ndalesë e rëndësishme për reflektim, koordinim dhe planifikim strategjik, duke krijuar hapësirën e nevojshme për analizë të punës së deritanishme dhe për ndërtimin e një qasjeje të përbashkët drejt rritjes së standardeve të shërbimit për qytetarët.

Hapet klinika dentare në Shtëpinë e Gjyshërve Shkodër, ku krahas shërbimit të fizioterapisë që tashmë ofrohet në ambiente tërësisht të rinovuara dhe funksionale, është shtuar edhe kujdesi dentar.

Me këto dy shërbime krijohet një paketë më e plotë kujdesi shëndetësor brenda vetë qendrës, duke e bërë jetesën e gjyshërve më të lehtë, më të sigurt dhe më cilësore.



Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, znj. Reme Xholi, mirëpriti në Shtëpinë e Foshnjës "Hannah dhe Rozafa" Zv/presidenten e Fondacionit Heydar Aliyev, znj. Leyla Aliyeva, një personalitet i njohur për angazhimin e saj të vazhdueshëm në nisma sociale, jo vetëm në Azerbajxhan, por edhe më gjerë.

Gjatë vizitës në Shtëpinë e Foshnjës "Hannah dhe Rozafa", znj. Aliyeva u njoh nga afër me shërbimet dhe përkujdesin e ofruar për fëmijët, si dhe me sfidat dhe nevojat e përditshme të institucionit. Ajo shprehu gatishmërinë e saj për t'u angazhuar në çështjet e përkujdesit ndaj fëmijëve, si edhe për të mbështetur familjet në nevojë në Shqipëri.



SHËRBIMI SOCIAL

Shërbimi Social Shtetëror

📍 Rruga e Durrësit, nr. 83, Tiranë, Shqipëri

☎ 044 54 18 21

✉ info@sherbimisocial.gov.al

🌐 www.sherbimisocial.gov.al